

RRITJA E AFTËSIVE TË ADMINISTRATORËVE TË SPORTIT PËR TË NDËRTUAR KAPACITETET E ORGANIZATAVE SPORTIVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR PËRMES VEPRIMTARIVE TË TRAJNIMIT DHE TË ZHVILLIMIT INOVATIV



KONTEKSTI DHE ARSYETIMI

S2ABC është një projekt i financuar nga BE-ja për ndërtimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe zhvillimit të aftësive në fushën e sportit.

Potenciali social dhe ekonomik i sportit tani njihet gjerësisht dhe ka një nivel në rritje të pritshmërisë që sektori të bëhet një mjet i fuqishëm i lidhur me politikën kryesore në arsim, shëndetësi dhe ekonomi, e që gjithashtu përdoret për të promovuar kohezionin social.

Për të arritur këto pritshmëri, është jetike për ata që punojnë me kohe te plote, ose janë vullnetarë në sektorin e sportit, të pajisen me aftësi dhe njohuri të nevojshme për të performuar në pozicionet e tyre të punës.

Ambicia e projektit S2ABC, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, është të mbështesë sektorin në realizimin e potencialit të tij duke rritur aftësitë e administratorëve të sportit, duke forcuar zhvillimin personal dhe mundësinë e punësimit të tyre në të ardhmen, e gjithashtu të krijojë organizata sportive më të forta.

Fokusi gjeografik i projektit është Ballkani Perëndimor, ku në rajon ka një periudhë unike të zhvillimit të organizatave sportive, si dhe të nevojës për aktivitete me synim ngritjen e kapaciteteve për t'i lejuar ato të rriten dhe të lulëzojnë përmes zhvillimit të aftësive të fuqisë së tyre punëtore.

Administrimi efektiv i sportit është çelësi për zhvillimin e sportit në rajon. Projekti do të zhvillojë aftësitë e atyre që punojnë në rolet e administratorëve sportive dhe që janë vendimtarë për modernizimin e organizatave sportive.



OBJEKTIVAT KRYESORE DHE NDIKIMI

Qëllimi i programit të punës S2ABC është t'u ofrojë mundësinë 70 pjesëmarrësve nga Bashkimi Evropian dhe katër vendeve të fokusuar të Ballkanit Perëndimor (Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi dhe Republikës së Maqedonisë të Veriut) për të marrë pjesë në një program që përputhet me qëllimin, një program trajnues transnacional për administradores e sportit.

S2ABC synon të ketë ndikimet e mëposhtme:

- ▶ Të rrisë aftësitë e pjesëmarrësve dhe të përmirësojë mundësinë e punësimit të tyre
- ▶ Të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve të organizatave sportive
- ▶ Të kontribuojë në zhvillimin e sportit në Ballkanin Perëndimor
- ▶ Të kontribuojë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në rajonin e Ballkanit Perëndimor
- ▶ Të promovojë dhe të bëjë realitet mobilitetin e të mësuarit në sektorin e sportit
- ▶ Të promovojë dimensionin ndërkombëtar të sportit, si dhe inkurajojë bashkëpunimin ndërrajonal
- ▶ T'i krijojë mundësi sportit që të pasurojë potencialin e tij, si dhe të përmbushë pritshmëritë e qeverive të Ballkanit Perëndimor.



PROGRAMET E TRAJNIMIT DHE PJSËMARRËSIT

Nepërmjet këtij projekti do të organizohen dhe do të ofrohen dy kurse Evropiane unike dhe innovative mbi Administrimin ne Sport,. Këto dy kurse do të ofrohen me një qasjeje të të mësuarit të përzier, të përbërë nga mësimi i drejtpërdrejtë online dhe që plotësohet nga vizitat individuale të pjesëmarrësve në fillim dhe në fund të programeve të studimit. Organizimi i vizitave kombëtare (pjesëmarrje individuale) do t'u japë mundësi pjesëmarrësve të shkëmbejnë kulturat, të zhvillojnë njohuritë e tyre për sistemet sportive në vende të ndryshme, si dhe do të rrisë njohuritë për institucionet, politikat dhe mekanizmat e BE-së.

Titujt e programeve të trajnimit do të jenë:

- ▶ Kursi Evropian për Administrimin e Sportit (40 pjesëmarrës)
- ▶ Kursi i Avancuar Evropian për Administrimin e Sportit (30 pjesëmarrës)

Pjesëmarrësit e kursit do të duhet të përfshihen aktivisht në drejtimin e një organizate sportive si: federatë sportive, klub sportiv, autoritet lokal, Komitet Olimpik Kombëtar, organizatat sportive të sportit per te gjithë etj. Partnerët do të sigurojnë një perzgjedhje me perfaqesues te ndryshem.



NJË NISMË TRANSNACIONALE

I koordinuar nga Observatori Evropian i Sportit dhe Punësimit (EOSE), projekti S2ABC përbëhet nga një konsorcium prej 7 partnerësh, duke përfshirë 3 Komitete Olimpik Kombëtar, 3 universitete dhe një rrjet sportiv evropian. Pesë prej partnerëve janë nga rajoni i Ballkanit Perëndimor.

PARTNERËT E PROJEKTIT S2ABC



Franca / Evropë – Koordinator

European Observatoire of Sport and Employment (EOSE)



Belgjika

Université Catholique de Louvain (UCL)



Maqedonia e Veriut

National Olympic Committee Macedonia (NOC Macedonia)



Shqipëria

Sports University of Tirana (SUT)



Shqipëria

National Olympic Committee of Albania (NOC Albania)



Kosova

University of Prishtina (UoP)



Mali i Zi

National Olympic of Committee of Montenegro (NOC Montenegro)

KONTAKTONI

Nëse ju dëshironi të merrni informacione të mëtejshme rreth projektit S2ABC, ju lutemi kontaktoni EOSE, Koordinatorin e Projektit, në: eoasesec@eose.org



www.s2abc-sport.eu

S2ABC financohet nga programi Erasmus+ Sport i BE-së (2022) «Ngritja e kapaciteteve në fushën e sportit» dhe zgjat nga Janari 2023 deri në Dhjetor 2024



Co-funded by
the European Union

Financuar nga Bashkimi Evropian. Megjithatë, pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian ose të Agjencisë Ekzekutive Evropiane të Arsimit dhe Kulturës (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as EACEA nuk mund të mbajnë përgjegjësi për to.